

## **Bullgaria pret me keqardhje vendimin për katedralen “Shën Sofia” në Stamboll**



Përkrahim thirrjet e bashkësisë ndërkombëtare për ruajtjen e regjimit të deritanishëm të aksesit në monumentin “Shën Sofia”, duke pasur parasysh historinë e tij dhe simbolin që ai e ka për fetë e krishtere dhe islame.

Shpresojmë se do të ruhet vlera e tij universale historike si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-së, thuhet në tekstin e publikuar në faqene internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Dje presidenti i Turqisë Rexhep Taip Erdogan nënshkroi dekret, me të cilin godina e “Shën Sofiasë” kalon nën udhëheqjen e Shërbimit të Çështjeve Fetare dhe do të përdoret si xhami.